



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 634 prot.

Tiranë, më 31. 03. 2026

V E N D I M

Nr. 62, datë 31. 03. 2026

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 313 Regj., datë 10.12.2025, e subjektit ankues E. Sh., kundër Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër², A. M., me pretendimin e diskriminimit për *shkak të gjinisë, gjendjes shoqërore, përkatësisë në një grup të veçantë dhe çdo shkak tjetër*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në parashtrimet e depozituara nga subjekti ankues, E. Sh., parashtron në ankesë se: “...Unë kam filluar punë në Prokurorinë Dibër më dt. 17.10.2024, si zëvendësues i Sekretares B. D. që ishte me leje lindje dhe më pas jam emëruar me Vendim Paraprak, në Korrik 2025, në pozicionin “Sekretar pranë prokurorëve” dhe kam qenë në periudhë prove... Mendoj që duke konsideruar ngarkesën time, e kam realizuar punën shumë mirë dhe në kohë, duke mbajtur të pa qepura fizikisht vetëm dosjet e Mosfillimit (theksoj të pa qepura fizikisht, pasi veprimet me këto dosje që janë: regjistrimi, fotokopje të vendimeve dhe njoftimi i palëve janë bërë të gjitha brenda 24 orëve nga marrja e dosjeve dhe po ashtu të gjitha dosjet e tjera janë kryer në kohë). Kjo ka ardhur jo vetëm për faktin e mbingarkesës që kam në funksionet e mia, por edhe me vetëdije, duke qenë se, që nga dita e parë kur kam filluar punë më është komunikuar drejtë për drejtë nga drejtuesi, kryesekretarja po ashtu edhe nga të gjithë punonjësit e tjerë, që dosjet e mosfillimit janë dosje që mund të presin për qepjen, e rëndësishme është që dosja të regjistrohet dhe të bëhen njoftimet e palëve dhe kjo e fundit është zbatuar me përpikmëri për çdo dosje që kam kaluar dhe më pas qepja fizike e tyre pret kur të kisha kohë, kjo e verifikueshme duke pyetur të gjithë kolegët.

Deri nga muaji mars i vitit 2025 unë kam punuar pothuajse rregullisht pas orarit të punës po ashtu edhe ditët e pushimit, në mënyrë që të hiqja pjesën fizike për dosjet e mosfillimit. Pas marsit na u

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Prokuroria Dibër.

komunikua nga Drejtuesi që nuk do duhet më pas orarit të punës ose në ditët e pushimit, por do të punojmë vetëm brenda 8 orëve zyrtare. Që nga ajo periudhë mua kanë filluar të më mblidhen çështjet e kategorisë “Mosfillimi”, ndërsa dosjet e tjera janë kryer në 100% të rasteve në kohë rekord nga ana ime duke bërë gati çdo dosje brenda afateve. Edhe pse kisha tej mase ngarkesë dhe më mblidheshin dosjet e mosfillimit, unë shfrytëzoja çdo moment për ti hequr edhe pas orarit të punës ose ditëve të pushimit nga që isha në gatishmëri dhe dilja për masa urgjente dhe këtë hyrje në zyrë e shfrytëzoja kur mundja që të hiqja këto dosje (theksoj përsëri vetëm qepja fizike pasi dosja në funksionin e saj ishte e përfunduar dhe nuk prishte asnjë punë qepja fizike e saj).

Në korrik marr edhe emërimin paraprak në pozicionin “Sekretar pranë prokurorëve” pasi u hap vend pune kështu që nuk isha më zëvendësues. Përveç ngarkesës, më vonë na u komunikua nga drejtuesi që në korrik do vinte edhe sekretarja tjetër dhe se do merrte funksionet e saj (mos gaboj kjo ka qenë në mbledhjen e qershorit që kemi bërë). Pasi mora këtë informacion, unë për shkak të mbingarkesës, përgatitjet e fashikujve penale të kategorisë “Mosfillime”, nuk po i mbaroja të gjitha vetëm për pjesën fizike, pasi njoftimet e palëve dhe regjistrimet e tyre janë kryer brenda afateve dhe përgatisja çështje që ishin me afate për në Gjykatë, sepse deri në korrik edhe pse me shumë sforcë ja kam arritur që ti përfundoj edhe fizikisht dosjet e mosfillimit (prandaj janë kryer deri në fund të korrikut), me idenë që do vijë Sekretarja dhe do marrë funksionet e saj (që praktikisht janë ato që bëj unë ose një pjesë e tyre), dhe më pas duke u lehtësuar nga ngarkesa e tepërt do kisha mundësi që të hiqja dosjet e mosfillimit të prapambetura.

Por kjo nuk ndodhi dhe madje pas asaj mbledhje mua më janë shtuar edhe punë e detyra të reja mbi ato që kisha, duke mu komunikuar nga drejtuesi që do i merrja unë përsipër derisa të vijë sekretarja nga leja e lindjes.

Pas korrikut mendova që gjatë muajit gusht do ketë më pak punë dhe duke qenë në gatishmëri për 2 javë do kisha mundësi ti hiqja, por gjatë gushtit puna ishte edhe më e ngarkuar duke qenë se bëja i vetëm punën e gjithë zyrës nga roja i derës e deri tek përfundimi i dosjeve (edhe këtu ja kam dalë me sukses pavarësisht ngarkesës tej normales dhe faktit që isha një punonjës i ri), në 2 javorshin e dytë kur gatishmërinë e mori sekretari A. B., unë përsëri kam qëndruar në punë pa shkëputje duke ndihmuar A. B. dhe duke hequr dosjet e prapambetura.

Përsëri duke menduar që në shtator do vijë sekretarja që ishte me leje, dosjet e mosfillimit i kam lënë vetëm për pjesën fizike pasi njoftimet, regjistrimet dhe protokollimet janë bërë të gjitha brenda afatit, me idenë që në shtator do shpërndaheshin punët, gjë e cila na është komunikuar nga Drejtuesi disa herë në mbledhje po ashtu edhe verbalisht mua, por që nuk ka ndodhur asnjëherë.

Në shtator bëj vetëm 4 ditë pushim dhe kur kthehem jo vetëm që punët nuk u rishpërndanë, por edhe dosjet që kishin ardhur gjatë 4 ditëve që unë isha me leje nuk ishin përfunduar por ishin lënë në zyrën time duke krijuar ngarkesë edhe më të madhe dhe jo vetëm kaq, por pas kësaj periudhe mora edhe një detyrë të re, duke më kaluar Regjistrin dhe Kasafortën për materialet e konfiskuara nga Prokurorët.

Më datë 13.11.2025 drejtuesi nuk ka qenë kur më ka ardhur një dosje sekrete dhe praktikisht, vjen në zyrën time Prokurori U. K. dhe më komunikon që do më sjellë një dosje që e ka sekrete dhe nuk duhet ta shikoj askush. Unë e pyes Prokurorin U. K. nëse do regjistrohet në Regjistrin tim për qarkullimin e brendshëm pasi është hera e parë që më vjen një dosje sekrete dhe nuk e dija si veprohej. Prokurori U. K. më tha që jo, sepse do regjistrohet dhe do përcillet me librin sekret që është në kryesekretari dhe më tha që unë të bëj pjesën time që është listimi, numërtimi, fotokopje dhe qepje fizike pastaj dosja do

kalonte në kryesekretari për vulosje, protokollim dhe regjistrim në libër sekret dhe në fund do nisej për postë.

Të nesërmen unë filloj të përgatis dosjen dhe kur isha drejt fundit dhe kisha vetëm për të bërë qepjen fizike të saj, vjen drejtuesi, i cili vjen pak me vonesë atë ditë.

Unë si çdo ditë tjetër i çoj drejtuesit regjistrin e qarkullimit me dosjet që kishin ardhur një ditë më parë, dhe drejtuesi më pyet nëse ka dosje tjetër, i them që nuk ka (në kuptimin e rutinës së përditshme, jo se doja ti fsheh ndonjë gjë, por edhe për faktin se dosja sekrete nuk ishte e përfunduar nga ana ime dhe po ashtu nuk do shkruhej në regjistrin tim por do shkruhej në regjistrin sekret në Kryesekretari). Drejtuesi më pyet përsëri në mënyrë specifike nëse ka dosje tjetër përveç atyre që i kisha çuar. I them që janë vetëm këto për regjistrin e qarkullimit dhe kam edhe një dosje sekrete të papërfunduar të Prokurorit U. K. në zyrë. Drejtuesi më thotë që ti çoj dosjen ta shoh dhe unë e vë në dijeni se dosja nuk është përfunduar dhe se Prokurori U. K. ka kërkuar që dosjen mos e shoh askush, atëherë Drejtuesi më thotë që në prokurori s'ka dosje sekrete për drejtuesin dhe se nuk kalon dosje pa e parë ai dhe unë shkoj në zyrë dhe i sjell dosjen (të gjitha këto janë të verifikueshme me kamerat e institucionit ose personeli).

Të them të drejtën rashë në një gjendje shumë të rënduar sepse duke qenë punonjës i ri dhe ngaqë nuk kisha bërë dosje sekrete, u futa në dilemë nëse kam shkelur ndonjë rregull në lidhje me drejtuesin apo nëse kisha shkelur ndonjë rregull në lidhje me dosjen sekrete të Prokurorit U. K., pasi tashmë i kisha nxjerrë sekretin.

Pak më vonë vjen Prokurori U. K., dhe më kërkon dosjen që ta çoj në kryesekretari për të kryer veprimet e mëtejshme dhe unë i them që dosjen e kam çuar te drejtuesi sepse më tha që është detyrim që çdo dosje i sheh ai, edhe ato sekrete. Normalisht Prokurori U. K. zemërohet me mua dhe më thotë, se përse ja çove pa dhënë leje unë, pasi më kishte komunikuar që s'duhet ta shoh asnjë dhe se dosja sekrete është vetëm për prokurorin e çështjes. Unë i komunikoj Prokurorit U. K. që e vura në dijeni drejtuesin për atë çfarë më kishte komunikuar Prokurori U. K., por Drejtuesi insistoi që duhet ta shikoj ai para se dosja të iki për postë sepse kështu është rregulli. Prokurori U. K. shkon në zyrën e drejtuesit që të marrë dosjen dhe dëgjoj që debatojnë, pak më vonë thirremi edhe ne të tjerët dhe na komunikohet nga Drejtuesi të gjithë punonjësve të Sekretarisë, që kjo dosje nuk do niset, nuk do vuloset, nuk do protokollohet dhe nuk do shkruhet në libër sekret, në atë moment vjen edhe Prokurori U. K. ku i kërkon të zbatojnë ligjin dhe të vulosin firmosin dhe të protokollojnë dosjen që të niset, por Drejtuesi refuzon dhe gjatë këtij debati dëgjoj Drejtuesin që i thotë Prokurorit U. K. që, kjo dosje nuk do të niset askund por do ta çosh vetë në postë.

Debatet vazhdojnë gjatë gjithë ditës, ku Prokurori U. K. i kërkonte kryesekretarisë që ti shërbenin dhe të vulosnin, protokollojnë dhe të nisin dosjen "Sekrete" nga ana tjetër drejtuesi nuk na lejonte. Në fund të shumë debateve ne sekretarët zbatuam atë çfarë na tha drejtuesi duke qenë se ne varemi prej tij dhe në fund të ditës u vendos që dosja nuk do protokollohet dhe shkruhet në regjistër sekret por thjesht do futet në zarf të vulosur me vulë të vogël të sekretarisë e do çohet në postë dhe ashtu u veprua.

Në këto rrethana më datë 26.11.2025, më thërret Kryesekretarja, A. Ç. dhe më komunikon një Urdhër për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

U habita se çfarë ka ndodhur, mora kopjen e Urdhrit, dhe më thonë që ka thënë drejtuesi brenda orës 12:30 duhet të dorëzoni detyrën dhe të largoheni që këtej. Bëra dorëzimin e detyrës dhe u largova.

Arsyet pse unë bëj këtë ankim janë, pasi besoj se jam diskriminuar për shkaqe që mund t'i shpjegojë vetë Drejtuesi i Prokurorisë i cili gjatë gjithë kohës së punës time vetëm më ka ngarkuar me punë dhe detyra të shumta duke krijuar një pabarazi midis nëpunësve civil apo punonjës të tjerë në institucion.

Sipas mendimit tim diskriminimet janë këto:

- *Preferenciale dhe gjinore duke më ngarkuar mua punë sa për të paktën 3-4 persona dhe duke i vënë në dispozicion Kryesekretares A. Ç., pasi i ka hequr vazhdimisht funksione asaj dhe më ka ngarkuar mua dhe për më tepër duke i lënë asaj 4 punonjëse femra në një zyrë duke e ndihmuar vetëm me protokoll dhe zarfa, që janë koordinatorja, ftuesja, arkivistja dhe që nga shtatori edhe Sekretarja që kisha zëvendësuar unë, B. D.*
- *Po ashtu mendoj edhe diskriminim për shkak Shoqërimi, ndoshta duke menduar që unë shoqërohem me Prokurorin U. K. me të cilin u bë edhe një debat shumë i madh për shkak të dosjes Sekrete për të cilën nuk mund të flas pasi ju do ta zbuloni vet për çfarë bëhet fjalë dhe do ta kuptoni.*
- *Po ashtu mendoj që diskriminuese, jo etike dhe profesionale dhe madje edhe në shkëlqje të ligjit është edhe komunikimi i urdhrit për shkëputje dhe urdhri për dorëzimin e detyrës brenda ditës, pasi dorëzimi parashikohet deri në 5 ditë.*
- *Besoj që ekzistojnë edhe diskriminime të tjera, psh për pjesën e orarit në mëngjes thirrem unë dhe disa të tjerë dhe qortohemi dhe këshillohemi madje kërcënohemi edhe për masa administrative, edhe përse ne vijmë të parët dhe të tjerëve që vijnë pas nesh nuk ju thuhet asgjë.*

Drejtuesi i Prokurorisë duke menduar se unë shoqërohem me prokurorin U. K. me të cilin u bë një debat institucional për çështjen e dosjes sekrete, mendoj që kjo është përdorur si motiv i drejtpërdrejtë për largimin tim nga detyra dhe jo për shkak të ngarkesës në punë, sepse asnjëra nga 2 arsyt e shkëputjes time nga puna nuk qëndrojnë.

Kjo rrethanë parashikohet në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", neni 3, pika 4, "Diskriminim për shkak të shoqërimit" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur ka një dallim, kufizim ose preferencë, për arsye të shoqërimit me persona që u përkasin grupeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, si dhe për shkak të supozimit për një shoqërim të tillë..."

Në kuadër të plotësimit të ankesës, përmes e-mail-it datë 11.12.2025, ankuesi ka informuar Komisionerin ndër të tjera se: "...

- *Shkaqet pse Drejtuesi e ka bërë këtë gjë nuk e di, por shkaqet e mia janë se unë kam bërë gabimin që nuk i kam thënë asnjëherë jo Drejtuesit, duke menduar që punët që mi kalonin mua do të rishpërndaheshin, gjë të cilën Drejtuesi na e ka thënë në të gjitha mbledhjet që kemi bërë dhe po ashtu ma ka thënë mua disa herë edhe verbalisht, duke më komunikuar që e dinë se kam shumë ngarkesë por të vazhdoj edhe pak, dhe kjo ka vazhduar për një vit rresht dhe rishpërndarja nuk është bërë asnjëherë. Gjëja më e keqe e kësaj pune është se unë në fund pastaj jam edhe pushuar nga puna me pretendimin që nuk kam kryer punën por që në fakt nuk është e vërtetë, sidomos po të llogarisësh ngarkesën tej normales, kështu që mendoj që kjo pjesë është jo vetëm diskriminim por edhe pa drejtësi dhe madje edhe shkelje ligji. Sa për provat unë i kam kërkuar me kërkesën që kam bërë pranë institucionit, por që nuk më kanë kthyer përgjigje dhe këtë kërkesë ua kam dërguar edhe juve si provë. Mënyra për të vërtetuar pretendimet e mia janë nëpërmjet librit të protokollit, emaileve të shkëmbyera me prokurorët dhe kolegët dhe më e mira mendoj do ishte pyetja e gjithë administratës në lidhje me punët e mia dhe të tjerëve dhe kështu do vërtetohej pabarazia dhe pa drejtësi e bërë ndaj meje.*

- Për diskriminim gjinor, mendoj që është fakti se mua vazhdimisht më janë ngarkuar punët e kryesekretares, madje edhe punë që janë ekskluzive për kryesekretaren, dhe po ashtu kjo mbështetet me faktin që Kryesekretarja A. Ç., Sekretarja B. D., Koordinatorja F. D., Ftuesja N. V. dhe Arkivistja M. T., kanë qenë pothuajse gjithë kohës në dispozicion të Kryesekretares duke e ndihmuar në punët e saj, që mesa kam dijeni unë është vetëm Protokolli, Vërtetimet dhe përgatitja e zarfave për postë. Kështu që mendoj se kjo është një formë diskriminimi gjinor pasi 5 femra kanë qenë me një zyrë duke bërë ndoshta vetëm 10% të punës së Sekretarisë dhe 90% të saj e bëja unë.
- ...për gjendjen shoqërore, siç e kam përmendur edhe në ankesën time të parë, nuk e di nëse është e saktë si formë diskriminimi, por arsyeja përse e mendoj këtë është sepse, besoj edhe ju e keni parë në media javën e kaluar atë çfarë ka ndodhur në këtë prokurori, ku Prokurori U. K. ka hapur Procedim Penal për Drejtuesin dhe duke qenë se unë dhe sekretari tjetër i regjistrit A. B. jemi shoqëruar me Prokuror U. K., gjë e cila është krejt normale, sepse shoqërimi jonë ka qenë si me çdo Prokuror tjetër aty, i vetmi ndryshim është se me Prokurorin U. K. ne mundet të jemi shoqëruar pak më shumë se të tjerët, por kjo vlen thjesht si fakt se ky prokuror është nga Peshkopia ndërsa të tjerët vijnë nga qytete të tjera.

Sekretari tjetër A. B. dhe unë kemi përgatitur dosjen e procedimit penal të Prokuror U. K. që ka bërë kundra drejtuesit dhe siç e kam sqaruar në ankesën e parë unë e kam parim pune që nuk i shikoj përmbajtjet e dosjeve, aq më shumë të kësaj dosje që erdhi si sekrete, unë kam zbatuar ligjin dhe kam bërë pjesën time përse i përket përgatitjes fizike të dosjes dhe përmbajtjen e saj e kam mësuar nga debati që ndodhi mes drejtuesit dhe Prokuror U. K. ditën që drejtuesi më kërkoi dosjen sekrete që ta shikonte dhe unë ja kam çuar, por përsëri në Urdhrin e shkëputjes nga vendi punës drejtuesi gënjen duke thënë që nuk i kam vënë në dispozicion dosjen sekrete të Prokuror U. K..

Duke qenë se kjo dosje ishte sensitive për drejtuesin dhe duke qenë se unë dhe A. B. kishim bërë regjistrimet përkatëse dhe përgatitjen fizike të dosjes, fakti që të 2 bashkë u hoqëm nga puna, duke shtuar këtu edhe faktin që drejtuesi ka menduar që ne e kemi bërë kastile sepse ai mendon që ne shoqërohemi me Prokuror U. K., atëherë kjo automatikisht të sjell në konkluzionin që drejtuesi e ka bërë si formë direkte hakmarrje ndaj nesh, kur në fakt ne kemi zbatuar ligjin dhe kemi bërë detyrën dhe për më tepër ne nuk kemi asnjë fuqi mbi dosjen ose diçka në lidhje me të kështu që edhe sikur të kishim ndonjë intencion ndaj drejtuesit ne nuk mundet të bënim asgjë sepse në radhë të parë s'mundemi dhe në radhë të dytë unë të paktën s'kam patur asnjë dijeni se për çfarë bëhej fjalë në atë dosje.

- ...për diskriminim për shkaqe të tjera, e lidh me faktin që përveç pabarazisë në shpërndarjen e punës mes meshkujve dhe femrave, ose më saktë mes meje dhe femrave, diskriminim tjetër mund të konsiderohet dhe preferenca e drejtuesit pasi për të njëjtën gjë punonjësit e tjerë janë trajtuar ndryshe nga unë, këtu mundet të përmend faktin për orarin në mëngjes, ku edhe pse unë jam ndër të parët që futem në institucion, unë thirrem nga drejtuesi dhe qorto hem, madje në rastin e fundit jam paralajmëruar edhe për masa disiplinore dhe të tjerët, në përgjithësi femrat, që vijnë shumica, gjithmonë mbas meje nuk ju thuhet gjë, ose fakt tjetër është se unë edhe pse kam qenë punonjësi më i ngarkuar në atë zyrë, kam bërë gjithmonë gatishmëri më shumë se të tjerët, p.sh. gushti, shtatori, kanë qenë 2 javë për mua dhe 2 javë për A. B. ndërkohë që kryesekretarja e ka bërë 2 muaj pushim, tetori dhe nëntori kanë qenë 20 ditë gatishmëri për mua dhe 10 ditë për A. B. Për provat në lidhje me gatishmërinë pjesën tjetër të vitit mbetet vetëm protokolli pasi

drejtuesi në mënyrë tinzare e ka shkruar 10 ditëshin e kryesekretares por në fakt shumicën e kohës e kam bërë unë dhe kjo mundet të vërtetohet vetëm duke gjetur rastet në protokoll pasi janë me shkrimin tim, emailt dhe duke pyetur edhe rojet e objektit sepse ato e dinë shumë mirë që gjithmonë unë kam dalë për gatishmëri shumicën e kohës së kryesekretares, por mundet edhe të pyeten vetë prokurorët, kolegët e mi dhe po ashtu kolegët policë dhe të gjykatës sepse me mua kanë komunikuar pothuajse për çdo rast, po ashtu unë jam thirrur dhe jam ngarkuar gjithmonë edhe punë fizike si për shembull kur kemi shkarkuar dhe hipur në kat të 4 të godinës mbi 5 kamionçina dosje të arkivit të zyrës së Burrelit, kam dalë dhe kam ndihmuar punëtorët natën jashtë orarit të punës për mobiliet e godinës së re, për lyerje ose punë të tjera që ato kishin jashtë orari, e kështu me radhë.

Rast tjetër mundet të përmend këtu lejet për pushime duke qenë se unë gjatë 1 viti kam marrë vetëm 4 ditë leje dhe ato i kam marrë si shpërblim për gatishmërinë e vazhdueshme dhe të pandërprerë, sepse nga drejtuesi dhe kolegët më është komunikuar vazhdimisht që nuk të takon leje e zakonshme, ndërkohë që të tjerët mundet të kenë marrë leje të vazhdueshme nganjëherë edhe 1 javë rresht dhe normal kjo më shumë për femrat jo për meshkujt.

- *... mua më është komunikuar që do marrësh edhe këtë punë, edhe këtë tjetrën e kështu me radhë duke më mbajtur me shpresa që do të rishpërndahen dhe çdo gjë do jetë e përkohshme, gjë që nuk ndodhi deri ditën e fundit, dhe më e keqja e kësaj pune është se unë u pushova nga puna pikërisht mbi pretendime false për mos zbatimin e detyrave dhe mashtrimeve që nuk i kam vënë drejtuesit dosjen sekrete në dispozicion, kështu që jam hequr nga puna për hakmarrje por në dokument është shkruar performanca e dobët dhe humbja e besimit, ndërkohë që kjo bie ndesh me atë çfarë thotë vetë Drejtuesi sepse si ka mundësi që një punonjësi që nuk punon dhe nuk performon ti ngarkohen detyra vazhdimisht, nuk bën sens, dhe kjo vërtetohet më shumë nga fakti që unë s'kam asnjë vërejtje, asnjë paralajmërim për këto gjëra, por në mënyrë tinzare nga drejtuesi dhe kryesekretarja në Urdhërin e largimit nga puna thuhet që gjoja ato më kanë këshilluar në mënyre verbale, gjë që është totalisht gënjeshtër sepse janë ato të 2 dhe po ashtu edhe kolegët e tjerë të cilët më kanë thënë verbalisht që dosjet e mosfillimit presin dhe meqë ke shumë ngarkesë mundet ti lidhesh fizikisht kur të kesh mundësi pasi ato s'prishin asnjë punë. Kështu që pasojë më të madhe se heqja nga puna për tjetër arsye që është hakmarrja dhe shkrimi në letër e diçkaje komplet tjetër pa lidhje normal që e bën akoma edhe më të rëndë diskriminimin e pësuar për 1 vit rresht, ku nga njëra anë mbahesha me shpresa që bëje ti se do ti rishpërndajmë dhe nga ana tjetër arrihet deri në pikën që pushohem nga puna se kam bërë diçka që ato vetë ma kanë thënë ta bëj.*

- *Për këtë arsye edhe nuk i kam adresuar këto shqetësime sepse mbahesha gjithmonë me shpresë që do rishpërndahen punët dhe normal që asnjëri se pret që të të ngarkohet 90% e punës së zyrës dhe në fund të të heqin nga puna se nuk arrite të bësh punën e të paktën 3-4 personave, s'ka sens dhe normal që nuk është as e drejtë por edhe jo ligjore.*
- *Përsa i përket dokumentacionit ... këto që do sjell kësaj radhe janë artikujt për procedimin penal për të provuar faktin që Drejtuesi për shkak se ka konflikt me Prokuror U. K. është hakmarrë ndaj meje ngaqë i bëra dosjen gati, ndoshta duke menduar që kam punuar me Prokuror U. K. pas shpinës së tij, gjë që është totalisht e pavërtetë sepse unë edhe po të doja skam asgjë në dorë, pasi fuqinë mbi një dosje e ka ekskluzivisht Prokurori çështjes... ”.*

Ndërsa me e-mail-in datë 15.12.2025, ankuesi sqaroi se: "...Përsa i përket rastit konkret, se përse unë mendoj që kjo ka ndikuar në diskriminimin tim, padrejtësinë dhe shkëputjen nga puna, është çështja e dosjes Sekrete të Prokuror U. K. që ka hapur çështje penale ndaj Drejtuesit, gjë që tashme është bërë edhe publike kështu që mundet që ta them.

Situata ka ndodhur e tillë, më datë 13.11.2025, më vjen Prokuror U. K. në zyrë dhe më thotë që do më sjellë një dosje, por është dosje sekrete dhe nuk dua që ta shikoj askush. E pyes Prokuror U. K. nëse kjo dosje do të regjistrohej tek regjistri im i qarkullimit të brendshëm dhe më thotë që jo dhe kjo dosje do regjistrohet te libri i dosjeve sekrete që e ka Kryesekretarja. Të nesërmen unë filloj të bëj pjesën time si me çdo dosje tjetër, listim, fotokopje, skanim dhe qepje fizike. Diku rreth drekës të datës 14.11.2025 vjen Drejtuesi dhe pak më vonë më thërret që ti çoj regjistrin tim bashkë me dosjet për firmë dhe unë ia dërgoj. Pak më vonë më thërret përsëri dhe më pyet nëse ka dosje tjetër, i them që jo pasi nuk kishte përfunduar akoma dosja sekrete e Prokuror U. K. (në vijim ankuesi citon informacionin e vënë më parë në përmbajtje të ankesës për situatën e ndodhur sa i përket dosjes sekrete)...

Pas kësaj dite drejtuesi vinte në zyrë dhe e shikojta që as nuk na përshëndeste, madje as nuk na shikonte në sy, të paktën për pjesën time. Më datë 21.11.2025, vijmë në zyrën time në formë kontrolli blic, drejtuesi, kryesekretarja, Prokurore R. XH. dhe 2-3 punonjës të tjerë dhe më komunikohet nga drejtuesi që do bëhet kontroll në kuadër të vlerësimit të punës meqë unë isha në periudhë prove. Unë ju them që s'kam asnjë dosje të papërfunduar, por kam vetëm dosjet e mosfillimit të cilat ishin vetëm për lidhje fizike, ashtu siç ato më kishin komunikuar vetë që nuk ka asnjë problem për përgatitjen fizike të tyre. Gjatë kësaj periudhe ne na rastisi që u ulëm në të njëjtën kafe me Prokuror U. K. dhe kjo ka qenë thjesht një kafe si gjithmonë, normal që u diskutua pjesa e dosjes, por çdo gjë ka qenë në kuadrin normal të bisedës.

Më datë 25.11.2025 marr edhe urdhrin për shkëputjen nga detyra me arsyet që, nuk ishin përgatitur dosjet e mosfillimit gjë që nuk ishte e vërtetë sepse çdo gjë ka qenë e përgatitur në pjesën funksionale të dosjes dhe pjesa fizike ka mbetur e tillë ashtu siç më kishin instruktuar ata vetë dhe më e rëndësishmja, përgatitja fizike e tyre nuk prish asnjë punë në funksionimin e punës së zyrës.

Arsyeja e dytë është që unë nuk i kam vënë në dispozicion drejtuesit dosjen sekrete të Prokuror U. K., gjë që është totalisht e pavërtetë, sepse unë ja vura në dispozicion dosjen, madje konflikti i madh që u krijua në zyrë ndodhi pikërisht sepse unë ja vura në dispozicion dosjen drejtuesit në një kohë që Prokuror U. K. më kërkoi në mënyrë specifike që dosjen s'do duhet ta shikoj askush.

Kështu që duke marrë parasysh këto që parashtrova, mendoj që ky është jo vetëm një diskriminim për hakmarrje ndaj meje por edhe një padrejtësi dhe madje edhe e kundërligjshme, sepse edhe fakti që largohemi nga puna në 2 sekretarët që kishim përgatitur dosjen dhe që njiheshim si persona që shoqëroheshim me Prokuror U. K. (pasi na thuhej vazhdimisht nga të tjerët që mos rrini me të, madje mua më thuhej që mos rri as me Prokuror U. K. as me Sekretarin A. B.), dhe shtu këtu që unë dhe A. B. kishim të paktën 90% të punëve të sekretarisë dhe puna nuk ngecte askund, madje ne e kishim përmirësuar punën jo vetëm tonën por të të gjithëve, A. B. me tabelat elektronike të Statistikave dhe unë me skanimet e dosjeve. Kështu që kjo është e qartë që, është thjeshtë një hakmarrje ndaj nesh me arsye të cilat nuk qëndrojnë dhe janë totalisht të pavërteta dhe kjo gjë do vërtetohet edhe në gjykatë kur ne të bëjmë ankesat përkatëse. Kjo është diskriminim për hakmarrje sepse përderisa arsyet e shkëputjes nga puna nuk qëndrojnë dhe madje janë gënjeshtër, kjo të çon automatikisht në këtë konkluzion...".

Sakaq, E. Sh. ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që në përfundim të shqyrtimit të ankesës, të konstatojë diskriminimin e tij nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, A. M. për shkak të *gjinisë, gjendjes shoqërore, përkatësisë në një grup të veçantë dhe çdo shkak tjetër*.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Bazuar në nenin 1, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), parashikohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në referencë të kësaj dispozite ligjore, rezulton se shkak i pretenduar nga ankuesja, *gjendja arsimore*, është shkak i mbrojtur, i parashikuara shprehimisht nga ligji, ndërkohë që nga ana tjetër, lista e shkaqeve të mbrojtura sipas nenit 1, të LMD nëpërmjet parashikimit “*ose me çdo shkak tjetër*”, është një listë e hapur shkaqesh..

Bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar (LMD), mbrojtja nga diskriminim garantohet *ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë*, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët *publikë apo privatë*, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

LMD, garanton mbrojtje nga diskriminimi në fushën e punësimit. Në nenin 12, pika 1, germa c, të LMD, sanksionohet se: *“1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;”*

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të ligjit.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 1732/3 prot., datë 17.12.2025, Komisioneri njoftoi palët, për fillimin e procedurës administrative, duke kërkuar parashtrime dhe informacion në lidhje me çështjen nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.

Në përgjigje sa më sipër, me shkresën³ nr. 02 prot., datë 05.01.2026, Prokuroria Dibër informoi Komisionerin duke parashtruar ndër të tjera se: “...**I. Me urdhërin nr. 45, datë 27.05.2025, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka urdhëruar:**

- *Fillimin e procedurës për plotësimin e vendit të lirë “Sekretar pranë prokurorëve” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.*
- *Krijimin e Komisionit të Pranimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për ndjekjen e procedurës për plotësimin e vendit të lirë “Sekretar pranë prokurorëve” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, sipas neneve 70-83 e vijues të ligjit nr. 97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.*

Me vendimin nr. 45/4, datë 17.07.2025, Komisioni i Pranimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka vendosur:

1. *Miratimin e rezultateve përfundimtare të kandidatëve, lidhur me procedurën e konkurrimit për emërimin në pozicionin e punës “Sekretar pranë prokurorëve”, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, si më poshtë vijon:*

Kandidati: E. Sh..

- *Dokumentacioni vlerësuar me 14 (katërbëdhjetë) pikë, nga 20 (njëzet) pikë të mundshme.*
 - *Testimi me shkrim vlerësuar me 45 (dyzet e pesë) pikë, nga 50 (pesëdhjetë) pikë të mundshme.*
 - *Intervista me gojë vlerësuar me 26 (njëzet e gjashtë) pikë, nga 30 (tridhjetë) pikë të mundshme.*
2. *Shpalljen fitues të procedurës së konkurrimit për emërimin në pozicionin e punës “Sekretar pranë prokurorëve”, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, të kandidatit E. Sh., vlerësuar gjithsej me 85 (tetëdhjetë e pesë) pikë, nga 100 (njëqind) pikë të mundshme.*
 3. *Vendimi i njoftohet Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.*
 4. *Vendimi i njoftohet të gjithë kandidatëve, ku ata të cilët nuk janë përzgjedhur fitues kanë të drejtë të ankimojnë vendimin në gjykatën kompetente.*

Me urdhërin nr. 52, datë 30.07.2025, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka urdhëruar:

³ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 44 prot., datë 07.01.2026

1. Emërimin paraprak në shërbimin civil të prokurorisë të E. Sh., në pozicionin “Sekretar pranë prokurorëve” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.
2. Njoftohet kandidati fitues E. Sh. se:
 - 2.1 Kandidati fitues E. Sh. do t’i nënshtrohet periudhës së provës në përputhje me kriteret ligjore, për një periudhë 1 (një) vjeçare.
 - 2.2 Kandidati fitues E. Sh. do të kryejë detyrat nën kujdesin e kryesekretares A. Ç..
 - 2.3 Në fund të periudhës së provës, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër vendos:
 - a) konfirmimin e nëpunësit civil;
 - b) zgjatjen e periudhës së provës një herë të vetme, deri në gjashtë muaj, nëse, për arsye të justifikuara, ka qenë i pamundur vlerësimi i nëpunësit civil; ose
 - c) moskonfirmimin e nëpunësit civil.

II. Në lidhje me ankesën nr. 313 regj., datë 10.12.2025, të subjektit ankues E. Sh..

Në lidhje me pretendimet e ngritura nga ana e subjektit ankues E. Sh. ju informojmë si më poshtë vijon:

- Në lidhje me dosjen e pretenduar “sekrete”, ju bëjmë me dije se bëhet fjalë për procedimin penal nr. 583, të vitit 2025, të regjistruar sipas vendimit për ndarjen e procedimit penal të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Më datë 14.11.2025, nga ana e sekretarisë (konkretisht nga ana e subjektit ankues E. Sh.) është sjellë për të nënshkruar tek Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër një shkresë dhe është vënë në dijeni Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër se nuk duhej që të vihej në dijeni me përmbajtjen e këtyre akteve, por vetëm duhej që të nënshkruante shkresën përcjellëse.

Pas kryerjes së verifikimeve në regjistrat përkatës dhe pas konstatimit se nga ana e prokurorit U. K. ngriheshin pretendime në lidhje me veprimtarinë funksionale të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka vlerësuar se nuk mund të firmosej kjo shkresë prej tij me cilësinë e drejtuesit, ndaj edhe i është kaluar për siglim zëvendësdrejtuesit të prokurorisë. Në vijim, nga sekretaria e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër është proceduar me dërgimin e materialit institucioni Përkatës.

Sa i përket “pretendimeve” dhe “aludimeve” të tjera nga ana e subjektit ankues E. Sh., nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër çmohet se nuk mund të gjejnë “arsyetim logjik”, por kanë ardhur për shkak të kërkesës së vazhdueshme të llogarisë, që Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka kërkuar, në funksion të veprimtarisë ligjore dhe kushtetuese, për të rritur besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë, si dhe për të siguruar mirëfunksionimin e institucionit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe zbatimin e urdhërave dhe udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Në vijim, ju informojmë se gjatë periudhës së ushtrimit të detyrave përkatëse nga ana e subjektit ankues E. Sh. nuk janë marrë masa disiplinore, pasi subjekti ankues E. Sh. ka qenë i emëruar paraprakisht, në periudhë prove, sipas parashikimeve të neneve 81, pikës 5 dhe 82 të ligjit nr. 97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në lidhje me verifikimet e kryera më datë 20.11.2025 në ambientet e zyrës së sekretarisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (ku ushtronte detyrat në pozicionin e Sekretarit” edhe subjekti ankues E. Sh.), është zhvilluar pasi nga verifikimet e kryera në arkivën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në funksion të zbatimit dhe të përmbushjes së detyrave të lëna në vendimin përfundimtar të inspektimit të Drejtorisë Qendrore në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave nr. DPA-DQ-2025-000124-5, datë 21.05.2025 dhe në funksion të verifikimit të zbatimit të urdhërave dhe të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Gjithashtu, specialistët e arkivës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër kishin raportuar tek Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër se nga ana e subjektit ankues E. Sh., për një periudhe rreth 4 muaj, nuk ishte dorëzuar një numër i konsiderueshëm fashikujsh të çështjeve penale, të cilat, sipas të dhënave nga zyra e regjistrimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, ishin përfunduar nga ana e prokurorëve.

Në këto rrethana, më datë 20.11.2025, janë kryer verifikime në ambientet e zyrës së sekretarisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (ku ushtronte funksionet në pozicionin e “Sekretarit” edhe subjekti ankues E. Sh.), duke u mbajtur edhe procesverbali përkatës i datës 20.11.2025.

Nga studimi i procesverbalit të datës 20.11.2025, lidhur me verifikimin e kryer më datë 20.11.2025, ka rezultuar se në zyrën e sekretarit të emëruar paraprakisht, në periudhë prove, E. Sh., janë konstatuar një sërë fashikujsh, 171 fashikuj çështjesh penale të painventarizuara, të panumërtuara dhe të paqepura, konkretisht:

- i. 141 fashikuj materialesh kallëzuese të mosfilluara nga data 21.07.2025 e në vijim.
- ii. 3 fashikuj referimesh pasurore të mosfilluara më datë 25.10.2025.
- iii. 27 fashikuj procedimesh penale të pushuara nga data 13.07.2025 e në vijim, madje për disa pre të cilave nuk kishin nisur edhe shkresat përcjellëse dhe kopje të vendimmarrjes së prokurorëve subjekteve të interesuara (kallëzues apo viktimë).

Në lidhje me verifikimet e kryera më datë 20.11.2025, ju sqarojmë se këto verifikime janë kryer në ambientet e zyrës së sekretarisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (ku ushtronte funksionet në pozicionin e “Sekretarit” edhe subjekti ankues E. Sh.).

Gjithashtu, prokurorët A. S., D. Z. dhe R. Xh. kanë ngritur pretendime dhe kanë kërkuar të merren masa lidhur me disa informacione/të dhëna të dala nga sekretaria dhe nga zyra e regjistrimit, lidhur me veprimtarinë e tyre si prokurorë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Për më tepër, prokurorja R. Xh. ka ngritur pretendime dhe ka kërkuar të merren masa lidhur me administrimin e akteve të një procedimi penal të hetuar dhe të përfaqësuar në gjykim nga prokurorja R. Xh., pa patur një kërkesë zyrtare për marrjen e kopjes së akteve të procedimit penal dhe pa mbajtur një procesverbal mbi dhënien e kopjes së akteve të procedimit penal nga personi përgjegjës (subjekti ankues E. Sh.) për qepjen dhe administrimin e fashikujve të procedimeve penale.

Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër çmohet se këto veprime nuk janë as “normale”, as “etike” dhe në tejkallim të kompetencave, si dhe në shkelje edhe të parimit të pavarësisë së prokuroreve, parashikuar në nenin 3, piken 2, të ligjit nr. 96, të vitit 2016 “Për statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në nenin 6 të ligjit nr. 97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, por edhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, që normojnë organizimin dhe funksionimin administrativ të prokurorisë.

Në lidhje me kryerjen e detyrave nga ana e subjektit ankues E. Sh. nën kujdesin e kryesekretares A. Ç., ju bëjmë me dije se subjekti ankues E. Sh. është këshilluar verbalisht herë pas here nga kryesekretarja A. Ç., jo vetëm gjatë kryerjes së detyrave, por edhe në mbledhjet tematike të zhvilluara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në të cilat subjektit ankues E. Sh., por edhe punonjësve të tjerë të stafit administrativ në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, u është theksuar dhe u është bërë e ditur detyrimi për ushtrimin e detyrave konform ligjit, si dhe në zbatim të urdhërave dhe të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Veprimet e subjektit ankues E. Sh., jo vetëm që kanë qenë në shkelje të urdhërave dhe të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, por kanë sjellë për pasojë cenimin e mirëfunksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (të zyrës së sekretarisë dhe të arkivës).

Në lidhje me ngarkesën e subjektit ankues E. Sh., nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër çmohet se ka qenë ngarkesë normale dhe modeste, duke mbajtur parasysh faktin se subjekti ankues E. Sh. ka patur detyrat e mëposhtme:

- *pranimin e dokumenteve dhe akteve procedurale;*
- *shpërndarjen e fashikujve sipas shënimit të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;*
- *fotokopjimin dhe lidhjen e fashikullit apo të materialeve të tjera hetimore;*
- *kryerjen e detyra të ngarkuara posaçërisht nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe nga kryesekretarja A. Ç. (ku nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër i është ngarkuar mbajtja e regjistrit të komunikimeve të brendshme (i cili mbahet në përmbushje të nenit 20 të udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet prokuroreve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, të ndryshuar).*

Gjithashtu, nga verifikimet e mëtejshme të kryera nuk ka rezultuar asnjë kërkesë me shkrim apo email nga ana e subjektit ankues E. Sh., ku të ketë parashtruar pretendime lidhur me vështirësi apo ngarkesë në kryerjen e funksionit të “Sekretarit”.

Në lidhje me procedurën që ndiqet për trajtimin e materialeve dhe informacionin “Sekret”, veprimet kryhen nga kryesekretaria, në zbatim të nenit 27, pikës 1.1.1, të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe të urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 58, datë 20.05.2025 “Për miratimin e listës së funksioneve organike që për shkak të detyrave zyrtare mund dhe duhet të njihen me informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, NATO-s, BE-së, shteteve dhe/ose organizatave të tjera ndërkombëtare”.

Për më tepër, në dijeninë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, subjekti ankues E. Sh. nuk dispononte Certifikatën e Sigurisë së Personelit (CSP) sipas parashikimeve të ligjit nr. 10, të vitit 2023 “Për informacionin e klasifikuar”, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 731, datë 27.11.2024 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë e personelit” dhe sipas urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 58, datë 20.05.2025 “Për miratimin e listës së funksioneve organike që për shkak të detyrave zyrtare mund dhe duhet të njihen me informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, NATO-s, BE-së, shteteve dhe/ose organizatave të tjera ndërkombëtare”, e jo më të zotëronte nivelin e kërkuar të Certifikatës së Sigurisë së Personelit (CSP) (sipas klasifikimeve sipas niveleve si vijojnë: “Tepër sekret”, “Sekret”, “Konfidencial” apo “I kufizuar”).

Ndaj, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër çmohet se nga subjekti ankues E. Sh. nuk janë zbatuar detyrimet e përcaktuara në zbatim të nenit 27, pikës 1.1.1, të rregullores për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, të ligjit nr. 10, të vitit 2023 “Për informacionin e klasifikuar”, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 731, datë 27.11.2024 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë e personelit” dhe të urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 58, datë 20.05.2025 “Për miratimin e listës së funksioneve organike që për shkak të detyrave zyrtare mund dhe duhet të njihen me informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, NATO-s, BE-së, shteteve dhe/ose organizatave të tjera ndërkombëtare”, por edhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, që normojnë organizimin dhe funksionim administrativ të prokurorisë.

Në lidhje me grafikët e shërbimit të gatishmërisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ju informojmë se gatishmëria për stafin administrativ në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër është planifikuar në zbatim të kreut II “Organizimi dhe funksionimi i gatishmërisë” të udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 8, datë 23.07.2024 “Për efektivitetin e shërbimit të gatishmërisë”.

III. Vlerësimi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Sa më sipër, ndërprerja e marrëdhënies së punës gjatë periudhës së provës për sekretarin e emëruar paraprakisht, në periudhë prove, E. Sh. dhe moskonfirmimi i sekretarit të emëruar paraprakisht, në periudhë prove, E. Sh., është bërë duke respektuar te drejtat e subjektit ankues E.

Sh. dhe pas konstatimeve të përshkruara sa më sipër, pasi veprimet e subjektit ankues E. Sh. nuk ishin në respektim dhe konform urdhërave dhe të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, të rregullores për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, që normojnë organizimin dhe funksionimin administrativ të prokurorisë.

Gjithashtu, me shkresën nr. 3607 prot., datë 25.11.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër i ka dërguar Drejtorisë së Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Prokurorinë e Përgjithshme urdhërin nr. 83, datë 25.11.2025, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, me objekt: “Ndërprerjen e marrëdhënies së punës gjatë periudhës së provës për sekretarin e emëruar paraprakisht” dhe kopje e procedurës së ndjekur për ndërprerjen e marrëdhënies së punës gjatë periudhës së provës për sekretarin e emëruar paraprakisht, në lidhje me subjektin ankues E. Sh..

Në lidhje me “pretendimet” dhe “aludimet” nga ana e subjektit ankues E. Sh., nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër çmohet se nuk mund të gjejnë “arsyetim logjik”, por kanë ardhur për shkak të kërkesës së vazhdueshme të llogarisë, që Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka kërkuar, në funksion të veprimtarisë ligjore dhe kushtetuese, për të rritur besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë, si dhe për të siguruar mirëfunksionimin e institucionit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe zbatimin e urdhërave dhe udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Qëllimi i vetëm i subjektit ankues E. Sh. është dezinformimi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe pasqyrimi i rrethanave të pavërteta, bazuar vetëm në “aludimet” e subjektit ankues E. Sh..

Këto “pretendime” dhe “aludime” nga ana e subjektit ankues E. Sh. përpiqen ta zhvendosin vëmendjen nga natyra e vërtetë e veprimtarisë së subjektit ankues E. Sh. dhe për më tepër është tregues i mungesës së theksuar të njohurive ligjore, i mungesës së angazhimit, i mungesës së përgjegjshmërisë në ushtrimin e funksionit, i mungesës së ndërgjegjësimit, i mungesës së ndjenjës së detyrës dhe përgjegjësisë nga ana e tij.

Gjithashtu, në “pretendimet” dhe “aludimet” e tij, subjekti ankues E. Sh. nuk ka shprehur kundërshtime lidhur me sa ka rezultuar nga verifikimet e kryera më datë 20.11.2025 në ambientet e zyrës së sekretarisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (ku ushtronte detyrat në pozicionin e “Sekretarit” edhe subjekti ankues E. Sh.), por është munduar të justifikojë veprimet dhe mosveprimet e tij lidhur me mosushtrimin e rregullt të detyrave të tij funksionale sipas akteve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara. Mosrespektimi i afateve për kryer këto detyra çmojmë se nuk ka qenë në tejkallim të “lehtë” të afateve të përcaktuara (si për shembull disa ditë tej afatit), por ka rezultuar mosushtrim i rregullt i detyrave të tij funksionale sipas akteve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara për një periudhë të pajustificuar (për disa muaj, duke filluar që na momenti kur subjekti ankues E. Sh. është emëruar paraprakisht)...

Sa parashtruam më sipër, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër vlerësohet që nuk ka patur diskriminim të subjektit ankues E. Sh. dhe nuk janë shkelur dispozitat e ligjit nr. 10221, të vitit 2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar”...”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Sipas informacionit të administruar, ankuesi, E. Sh., ka filluar punë në Prokurorinë Dibër më datë 17.10.2024, si zëvendësues, në pozicionin “Sekretar pranë prokurorëve”. Me Urdhërin nr. 45, datë 27.05.2025, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka urdhëruar:

- Fillimin e procedurës për plotësimin e vendit të lirë “Sekretar pranë prokurorëve” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.
- Krijimin e Komisionit të Pranimi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për ndjekjen e procedurës për plotësimin e vendit të lirë “Sekretar pranë prokurorëve” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, sipas neneve 70-83 e vijues të ligjit nr. 97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Pasi ankuesi është vënë në dijeni të shpalljes së pozicionit të lirë “Sekretar pranë prokurorëve” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, ka aplikuar dhe dorëzuar dokumentacionin e kërkuar.

Me vendimin nr. 45/4, datë 17.07.2025, Komisioni i Pranimi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka vendosur:

- Miratimin e rezultateve përfundimtare të kandidatëve, lidhur me procedurën e konkurrimit për emërimin në pozicionin e punës “Sekretar pranë prokurorëve”, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për E. Sh., si më poshtë vijon:
 - Dokumentacioni i vlerësuar me 14 (katërbëdhjetë) pikë, nga 20 (njëzet) pikë të mundshme;
 - Testimi me shkrim vlerësuar me 45 (dyzet e pesë) pikë, nga 50 (pesëdhjetë) pikë të mundshme;
 - Intervista me gojë vlerësuar me 26 (njëzet e gjashtë) pikë, nga 30 (tridhjetë) pikë të mundshme;
- Në total ankuesi ishte vlerësuar me 85 (tetëdhjetë e pesë) pikë, nga 100 (njëqind) pikë të mundshme.

Ligji Nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Neni 80, përcakton se:

“1. Organi kompetent për emërimin e nëpunësve të tjerë civilë në prokuroritë përkatëse është drejtuesi i prokurorisë.

2. Për vendet e lira për nëpunësit e tjerë civilë, pas përfundimit të procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, kandidatët e renditur në listën e kandidatëve nga komisionet e pranimi, kanë të drejtë

të paraqesin kërkesë pranë drejtuesit të prokurorisë.

3. Komisioni i Pranimit fton kandidatët për intervistë dhe zgjedh kandidatin për vendin e lirë përkatës në shërbimit civil, duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme, sipas kësaj radhe:

a) renditjen në listën e kandidatëve;

b) çdo karakteristikë e veçantë e kandidatit në lidhje me vendin e lirë;

c) vitet e përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose përvoja të tjera profesionale që lidhen me vendin përkatës.

4. Komisioni i Pranimit arsyeton dhe publikon vendimin për rezultatet e procedurës së emërimit. Vendimi i arsyetuar i njoftohet të gjithë kandidatëve. Kandidatët që nuk janë përzgjedhur kanë të drejtë të ankimojnë vendimin në gjykatën kompetente”.

Ndërsa Neni 81, i Ligjit Nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se:

“ 1. Nëpunësi i shërbimit civil merr emërimin paraprak në shërbimin civil të prokurorisë me kushtin që vendimi i emërimit të mos cenohet nga një vendim gjyqësor.

2. Në rast se nuk bëhet ankim brenda afatit kundër vendimit të organit kompetent për emërimin e nëpunësve të shërbimit civil, vendimi bëhet përfundimtar dhe emërimi konsiderohet përfundimtar që nga data e mbarimit të afatit të ankimit ndaj këtij vendimi.

3. Në rast se bëhet ankim dhe vendimi gjyqësor përfundimtar lë në fuqi vendimin e emërimit, emërimi konsiderohet përfundimtar, duke filluar nga dita e njoftimit të vendimit gjyqësor të nëpunësi civil i emëruar.

4. Në rast se gjykata e cenon vendimin e emërimit, organi kompetent përkatës rivlerëson, sipas rregullave të vlerësimit, të gjitha kërkesat e kandidatëve në përputhje me këtë ligj dhe merr një vendim të ri pas dhënies së vendimit përfundimtar të gjykatës. Emërimi paraprak konsiderohet i përfunduar në datën e vendimit të organit kompetent, i cili rishikon vendimin e emërimit duke pasur parasysh vendimin përfundimtar të gjykatës. Kandidatët e emëruar paraprakisht dhe të porsaemëruar njoftohen në datën e dhënies së vendimit.

5. Viti i parë i shërbimit gjatë periudhës së emërimit paraprak konsiderohet si periudhë prove, sipas nenit 82 të këtij ligji...”.

Në përfundim të procedurës së konkurrimit, me Urdhërin Nr. 52, datë 30.07.2025, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka urdhëruar: “Emërimin paraprak në shërbimin civil të prokurorisë të E. Sh., në pozicionin “Sekretar pranë prokurorëve” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Në vijim, në datën 14.11.2025, sipas informacionit të administruar, nga ana e Prokurorit të Prokurorisë Dibër U. K., i është dorëzuar një dosje për të kryer veprimet e mëtejshme të sekretarisë, ankuesit, E. Sh.. Sipas të dhënave, dosja kishte të bënte me veprimtarinë funksionale të Drejtuesit të Prokurorisë Dibër, A. M.. Sakaq, ankuesi është paraqitur pranë Drejtuesit të Prokurorisë duke i vënë në dispozicion për të nënshkruar shkresën përcjellëse të saj dhe e ka informuar se nuk mund të kishte dijeni rreth përmbajtjes për shkak të faktit se ajo kishte në brendësi informacion të klasifikuar “Sekret”.

Pas kryerjes së verifikimeve dhe konstatimit se nga ana e prokurorit U. K. ngriheshin pretendime në lidhje me veprimtarinë funksionale të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, u vlerësua se shkresa përcjellëse e saj duhej të përcillej me nënshkrimin e zëvendës drejtuesit të prokurorisë.

Sakaq, ankuesi pretendon se pas këtij momenti nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë Dibër është ngritur një grup pune për kontrollin dhe vlerësimin e rezultateve të tij në punë.

- ***Në lidhje me pretendimet e ankuesit për diskriminim nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, A. M..***

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, me Urdhërin Nr. 52, datë 30.07.2025, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, ankuesi ka marrë: *“Emërimin paraprak në shërbimin civil të prokurorisë të E. Sh., në pozicionin “Sekretar pranë prokurorëve” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”*.

Referuar Urdhërit Nr. 52, datë 30.07.2025, të emërimit të E. Sh. në pozicionin *“Sekretar pranë prokurorëve”*, në pikën 2.1 të tij, përcaktohet se: *“2.1. Kandidati fitues E. Sh. do t'i nënshtrohet periudhës së provës në përputhje me kriteret ligjore, për një periudhë 1 (një) vjeçare”*.

Në datën 13.11.2025, sipas informacionit të vënë në dispozicion nga ana e ankuesit, theksohet se nga ana e Prokurorit të Prokurorisë Dibër U. K., ankuesit i është dorëzuar një dosje për të kryer veprimet e mëtejshme të sekretarisë, për të bërë listimin, numërtimin, fotokopje dhe qepje fizike pastaj dosja duhet të kalohej në Kryesekretari për vulosje, protokollim dhe regjistrim në libër sekret dhe në fund do nisej për postë.

Sipas të dhënave, dosja kishte të bënte me veprimtarinë funksionale të Drejtuesit të Prokurorisë Dibër, A. M.. Sakaq, më datë 14.11.2025, ankuesi është paraqitur pranë Drejtuesit të Prokurorisë duke i vënë në dispozicion për të nënshkruar shkresën përcjellëse të saj dhe e ka informuar se nuk mund të kishte dijeni rreth përmbajtjes së dosjes për shkak të faktit se ajo kishte në brendësi informacion të klasifikuar *“Sekret”*.

Në Nenin 27, të Rregullores Standard *“Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”*, miratuar me Urdhërin Nr. 37, datë 25.03.2024⁴, përcaktohet se: *“1 . Veprimtaria e sekretarisë në prokurori dhe veprimtaritë e tjera, që kryhen rregullisht prej saj nëpërmjet kryesekretarit dhe sekretarëve sipas strukturave përkatëse janë:*

1.1 Kryesekretari i prokurorisë në përmbushjen e detyrave funksionale kryen këto detyra, por jo vetëm:

a) administron dhe kujdeset për të gjitha materialet shkresore që hyjnë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;

⁴ Të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

b) kryen regjistrimin e tyre në regjistrat përkatës sipas lëndës së materialit të ardhur dhe i indeksin;

c) organizon dhe mban përgjegjësi për punën që bëhet në kryesekretari;

ç) përcjell tek Drejtuesi i Prokurorisë çdo material të ardhur dhe të regjistruar;

d) shpërndan materialet sipas siglimit të Drejtuesit të Prokurorisë;

dh) kryen veprimet e nevojshme për dërgimin me postë të dosjeve penale për në gjykatë, polici, etj;

e) kryen veprimet e nevojshme për dërgimin me postë të njoftimeve të vendimeve të mosfillimit, pushimit, kërkesave për gjykim, urdhrave të ekzekutimit, etj;

e) regjistron dhe dërgon në gjykatë kërkesat për caktim mase sigurimi, lejim përgjimi, lejim kontrolli dhe çdo kërkesë tjetër drejtuar gjykatës në fazën e hetimeve paraprake, seancës paraprake, gjykimit të themelit dhe ekzekutimit të vendimeve penale të formës së prerë;

f) dërgon në institucione të tjera dosje të pezulluara, të pushuara apo për gjykim, të shoqëruara vetëm me nënshkrimin e Drejtuesit të Prokurorisë dhe/ose nga personi/funksionari i autorizuar prej tij sipas ligjit;

g) nën kujdesin e kancelarit të prokurorisë, merr masat e nevojshme dhe të domosdoshme për të mirëmbajtur brenda kushteve teknike të gjithë dokumentacionin arkivor;

gj) përpilon kthimin e përgjigjeve për institucionet e ndryshme dhe kërkesë ankesave për problemet që lidhen me punën e kryesekretarisë;

h) për çdo material të fotokopjuar vërteton njësinë me origjinalin;

i) përpunon në fund të çdo muaji, sipas rregullave për administrimin e dokumenteve, shkresat që do të dorëzohen në sekretari-arkiv;

j) dorëzon në arkiv me procesverbal, fashikujt/dosjet e mosfilluara dhe pushuara (pasi janë sigluar nga drejtuesi i prokurorisë) si dhe librat e protokolleve dhe librat e dorëzimit të brendshëm e të jashtëm pasi janë sekretuar.

1.1.1 Kryesekretari i ngarkuar me punën/informacionin “Sekret Shtetëror” kryen edhe këto detyra:

a) zbaton me përpikmëri aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në lidhje me marrjen, dërgimin, regjistrimin, qarkullimin, shfrytëzimin, shumëfishimin, dhe arkivimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”;

b) verifikon nëse informacioni i klasifikuar “sekret shtetëror” që prodhohet ose administrohet brenda institucionit, si dhe informacioni që merret e dërgohet nga institucioni, përmbush kërkesat e përcaktuara në rregulloren “Për punën me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”;

c) shpërndan për shfrytëzim informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” me miratim të titullarit, vetëm tek ata punonjës, të cilët janë pajisur me “certifikatë sigurie” të përshtatshme;

ç) sistemon të gjithë informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” që ka në ngarkim;

d) zbaton afatet e përcaktuara për shfrytëzim, qarkullimin, ruajtjen dhe arkivimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”;

dh) plotëson saktë, mirëmban dhe përdor vetëm regjistrat dhe librat e modeluar nga DSIK-ja, në lidhje me regjistrimin, qarkullimin, shfrytëzimin, marrjen, dërgimin dhe shumëfishimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” që ka në ngarkim;

e) ruan informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” në kasafortë dhe/ose dollapë metalikë, në zbatim të rregullave të sigurimit fizik të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”;

e) ndërron periodikisht kodet në rastet e përdorimit të kasafortave apo dollapëve metalikë që operojnë me anë të këtyre sistemeve;

f) sistemon dhe inventarizon informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, para dorëzimit në arkivin e institucionit;

g) dorëzon dokumentet dhe/ose materialet e klasifikuara nga zyra e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” në arkivin e institucionit, pasi kanë kaluar 2 (dy) deri në 10 (dhjetë) vjet nga koha e krijimit të tyre;

gj) komunikon sipas rregullave me postën dhe zyrat e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” të ministrive apo institucioneve të tjera;

h) administron, mirëmban dhe ruan vulën e institucionit.

....

....

2.3 Sekretari i prokurorëve në përmbushjen e detyrave funksionale kryen këto detyra, por jo vetëm:

a) pranon dokumentet dhe aktet procedurale;

b) shpërndan fashikullin sipas shënimit të drejtuesit të prokurorisë;

c) bën fotokopje, lidhjen e fashikulli apo të materialeve të tjera hetimore, sipas kërkesës së prokurorit;

ç) kryen detyra të ngarkuara posaçërisht nga drejtuesi, kancelari apo prokurori që asiston, për të mbështetur dhe lehtësuar punën e tyre...”.

Në analizë të sa më sipër cituar, vlerësohet se, Kryesekretari i ngarkuar me punën/informacionin “Sekret Shtetëror”, është përgjegjës për marrjen, dërgimin, regjistrimin, qarkullimin, shfrytëzimin, shumëfishimin, dhe arkivimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”. Pra, subjekti ankues, E. Sh., nuk ka kompetencë apo detyrë funksionale të tij, përpunimin e dokumentacionit apo informacionit “Sekret shtetëror”. Gjithashtu, vlerësohet se shfrytëzimi i informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” me miratim të titullarit, bëhet vetëm nga ata punonjës, të cilët janë pajisur me “certifikatë sigurie” të përshtatshme. Në rastin konkret, por edhe nga të dhënat e administruara, ankuesi nuk ka disponuar “certifikatë sigurie”, për të ndjekur procedurat e ngarkuara nga aktet ligjore në fuqi, për regjistrimin, qarkullimin, shfrytëzimin, shumëfishimin, dhe arkivimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”.

Në këtë kuadër, nuk rezulton se ankuesi ka zbatuar detyrimet e përcaktuara në aktet ligjore apo nënligjore në fuqi, sa i përket regjistrimin, qarkullimin, shfrytëzimin, shumëfishimin, dhe arkivimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”.

Sa më sipër dhe në kuadër të vlerësimit të rezultateve të ankuesit në punë, Drejtuesi i Prokurorisë Dibër, A. M., përmes e-mail-it datë 20.11.2025, ka ngritur një grup pune për kryerjen e verifikimeve përkatëse.

Në këto rrethana, më datë 20.11.2025, janë kryer verifikime në ambientet e zyrës së sekretarisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, ku ushtronte

funksionet në pozicionin e “Sekretarit” edhe subjekti ankues E. Sh., duke u mbajtur edhe procesverbali përkatës i datës 20.11.2025.

Mbështetur në gjetjet e procesverbalit të datës 20.11.2025, lidhur me verifikimin e kryer, ka rezultuar se në zyrën e sekretarit të emëruar paraprakisht, në periudhë prove, E. Sh., janë konstatuar 171 fashikuj çështjesh penale të painventarizuara, të panumërtuara dhe të paqepura, konkretisht:

- 141 fashikuj materialesh kallëzuese të mosfilluara nga data 21.07.2025 e në vijim,
- 3 fashikuj referimesh pasurore të mosfilluara më datë 25.10.2025
- 27 fashikuj procedimesh penale të pushuara nga data 13.07.2025 e në vijim, nga të cilat në dy raste nuk ishin nisur edhe shkresat përcjellëse dhe kopje të vendimmarrjes së prokurorëve subjekteve të interesuara (kallëzues apo viktimë).

Gjithashtu, evidentohet se më datë 20.11.2025, prokurorët A. S., D. Z. dhe R. Xh. kanë bërë me dije drejtuesin e Prokurorisë Dibër, përmes e-mail-it dhe shkresës zyrtare, lidhur me disa informacione apo të dhëna të dala nga sekretaria dhe nga zyra e regjistrit, mbi veprimtarinë e tyre si prokurorë.

Përmes shkresës nr. 3567 prot., datë 20.11.2025, prokurorja, R. Xh., ka ngritur pretendime dhe ka kërkuar të merren masa lidhur me administrimin e akteve të një procedimi penal të hetuar dhe të përfaqësuar në gjykim prej saj, pa patur një kërkesë zyrtare për marrjen e kopjes së akteve të procedimit penal dhe pa mbajtur një procesverbal mbi dhënien e kopjes së akteve të procedimit penal nga personi përgjegjës për qepjen dhe administrimin e fashikujve të procedimeve penale.

Ndërsa, prokurorët A. S., D. Z., përmes e-mail-it datë 20.11.2025, kanë ngritur pretendime se prokurori, U. K., është vënë në dijeni të disa informacioneve lidhur me dosjet që ata kanë në shqyrtim, pa miratimin e tyre. Në këtë kuadër, kanë kërkuar të vihen në dijeni dhe të merren masat përkatëse për shkelje të privatësisë së punës së prokurorit, lidhur me mënyrën se si ka mundur U. K. të marrë informacion mbi dosje që ata kanë në hetim.

Sa më sipër, me Urdhërin Nr. 83, datë 25.11.2025, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, ka urdhëruar:

1. Ndërprerjen e marrëdhënies së punës gjatë periudhës së provës për sekretarin e emëruar paraprakisht, në periudhë prove, E. Sh., për shkak të shkeljeve shumë të rënda të konstatuara dhe të pasqyruara në këtë urdhër.
2. Moskonfirmimin e sekretarit të emëruar paraprakisht, në periudhë prove, E. Sh. në pozicionin “Sekretar pranë prokurorëve” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Mbështetur në gjetjet e cituara në urdhrin e mësipërm, theksohet se: “...*gjatë periudhës së provës janë konstatuar mospërmbushje të detyrave dhe disa problematika në ushtrimin e funksionit nga ana e sekretarit të emëruar paraprakisht, në periudhë prove, E. Sh., të parashtruara si më poshtë vijojnë:*

- *Nuk ka realizuar në vijimësi dhe në mënyrën e duhur mbajtjen, formimin dhe administrimin e dosjeve/fashikujve, detyrë kjo e përcaktuar sipas pikës 7 udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm*

Dibër nr. 43, datë 02.04.2024 “Për normimin e disa rregullave për kalimin administrativ të fashikujve të çështjeve penale të përfunduara”, sipas nenit 59 të ligjit nr. 97, të vitit 2016 Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe sipas nenit 27, pikës 2.3, të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (kjo situatë ka rezultuar gjatë verifikimit të kryer më datë 20.11.2025 dhe është pasqyruar nëpërmjet procesverbalit të mbajtur më datë 20.11.2025 të përshkruar me lart), ku këto veprime kanë sjellë pasojë edhe në funksionimin e arkivit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

- *Nuk ka informuar Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër lidhur me sa i është kërkuar në funksion të qarkullimit të shkresave, akteve dhe materialeve hetimore, me pretendimin se bëhej fjalë për “sekret”, veprime këto në kundërshtim me nenet 52, pikat 1 dhe 3 dhe 59 të ligjit nr. 97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me udhëzimin e përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, të ndryshuar dhe me nenin 27 të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, por edhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, që normojnë funksionimin administrativ të prokurorisë.*

Gjithashtu, gjatë periudhës së provës, por edhe në mbledhjet e zhvilluara, nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe nga kryesekretarja e prokurorisë është këshilluar vazhdimisht në mënyrë verbale sekretari i emëruar paraprakisht, në periudhë prove, E. Sh..

Sa më sipër, çmohet se veprimet e sekretarit të emëruar paraprakisht, në periudhë prove, E. Sh., përveç se janë tregues i mungesës së njohurive mungesës së përkushtimit në punë dhe mungesës së etikës në punë, kanë cenuar rëndë mirëfunksionimin dhe besueshmërinë institucionit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër...”.

Mbështetur në provat e administruara dhe ato të sipërcituara, vlerësohet se:

- ankuesi nuk ka zbatuar detyrimet e përcaktuara në aktet ligjore apo nënligjore në fuqi, sa i përket regjistrimin, qarkullimin, shfrytëzimin, shumëfishimin, dhe arkivimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”;
- ankuesi nuk ka realizuar në vijimësi dhe në mënyrën e duhur mbajtjen, formimin dhe administrimin e dosjeve/fashikujve, mbështetur në detyrimet e përcaktuara në detyrat funksionale të parashikuara në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”.

Përfundimisht, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesi, z. E. Sh., nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, në lidhje me pretendimet e parashtuara në ankesë, nga ana e punëdhënësit/ Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, A. M.. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa “a” dhe nenin 33, pika 10, 11 e 12, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit, z. E. Sh., nga ana e punëdhënësit/ Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, A. M..
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: gjinia, gjendja shoqërore, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo shkak tjetër)
(Fusha: Punësim)